

Dog Coaching Center

Tiranë, Shqipëri

www.dogcoachingcenter.com

Trajnerët:

Kornelia KOKONA

Arbër TËRVOLI



Si të kemi një qen të qetë në shtëpi

3 strategji për pronarët



Tri strategji praktike për një qen më të qetë, më të sigurt dhe më të menaxhueshëm

Sa herë jeni ndjerë në siklet kur dikush ka ardhur në shtëpi dhe qeni juaj ka dalë jashtë kontrollit?

Sa herë ju është dashur ta kapni nga qaforja, ta shtyni ose të ngrini zërin për ta larguar nga dera, divani, tavolina apo dhe të ftuarit?

Ndoshta qeni juaj leh sa herë dëgjon një zhurmë jashtë, qëndron vazhdimisht pas jush edhe kur nuk ia kërkoni, ju kërkon ushqim ndërsa hani ose nuk arrin të qetësohet kur e lini vetëm.

Këto situata nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht se keni një qen “të keq” ose të patrajnueshëm. Shpesh tregojnë se qenit i mungojnë kufij të qartë, një rutinë e parashikueshme dhe udhëzimi i nevojshëm për të kuptuar se çfarë pritet prej tij në shtëpi.

Menaxhimi nuk ka për qëllim ta kufizojë qenin ose t’i heqë lirinë. Përkundrazi, ai na ndihmon:

- të parandalojmë sjelljet e padëshiruara;
- të shmangim konfliktet dhe përdorimin e forcës;
- t’i mësojmë qenit vendimmarrje më të përshtatshme;
- të krijojmë një ambient më të qetë dhe më të sigurt;
- t’i japim qenit gradualisht më shumë liri, kur ai është vërtetë gati për të.

Në këtë e-book do t’ju prezantojmë tri strategji praktike:

1. Mbajtjen e një litari të vënë brenda shtëpisë;
2. Ushtrimin “Tek Vendi” në një krevat të ngritur;
3. Përdorimin e kafazit të trajnimit.

Këto mjete nuk zëvendësojnë aktivitetin fizik, stimulimin mendor, shëtitjet, socializimin apo punën individuale me një profesionist kur qeni ka probleme serioze sjelljeje. Ato na ndihmojnë të krijojmë strukturën brenda së cilës qeni mund të mësojë.

STRATEGJIA 1 - Mbajtja e litarit brenda shtëpisë

Pas shëtitjes, veprimi i parë që bëjnë shumë pronarë është heqja e litarit.

Në atë moment, disa qen nisin të vrapojnë nëpër shtëpi, të kërcëjnë mbi mobilje, të luajnë, të përplasen me njerëzit ose të vazhdojnë aktivitetin sikur shëtitja të mos kishte përfunduar ende.

Nuk ka asgjë të gabuar që një qen të luajë, të vrapojë ose të qëndrojë mbi mobilje, nëse kjo përputhet me rregullat e familjes suaj. Problemi fillon kur ne nuk kemi më një mënyrë të qetë dhe të sigurt për ta drejtuar sjelljen e tij, ndërkohë që bashkëjetesa me qenin nuk është ideale.

Kur qeni bën diçka që nuk na pëlqen, reagimi ynë i parë shpesh është:

- të ngremë zërin;
- ta kapim nga qaforja;
- ta shtyjme me trup;
- ta tërheqim me duar;
- ose, nëse është i vogël, ta marrim në krahë dhe ta largojmë.

Këto ndërhyrje mund të jenë të papritura dhe konfliktuale për qenin. Ato mund të ndalojnë sjelljen për momentin, por jo domosdoshmërisht i mësojnë atij se çfarë duhet të bëjë në vend të saj.

Qentë mësojnë gjatë gjithë kohës, jo vetëm gjatë seancave formale të trajnimit. Për këtë arsye, çdo situatë e përditshme është një mundësi për t'i mësuar qenit si të sillet në ambientin ku jeton.



Litari si mjet drejtimi

Një litar i thjeshë kapur në qafore, i mbajtur brenda shtëpisë vetëm gjatë kohës kur qeni është nën vëzhgim, mund të jetë një nga mjetet më të dobishme të menaxhimit.

Ai krijon një lidhje të qartë ndërmjet jush dhe qenit, duke ju lejuar ta drejtoni pa e ndjekur, pa e kapur me forcë dhe pa hyrë vazhdimisht në hapësirën e tij personale.

Mendojeni litarin si një linjë komunikimi: ai ju ndihmon t'i tregoni qenit drejtimin, distancën dhe kufijtë e nevojshëm, pa e kthyer çdo situatë në konflikt.

E rëndësishme për sigurinë

Litari i shtëpisë duhet të përdoret:

- vetëm kur qeni është nën mbikëqyrje;
- pa një dorezë të madhe që mund të kapet pas mobiljeve;
- larg shkallëve, dyerve dhe objekteve ku mund të ngatërrohet;
- në një qafore.

Mos e lini qenin vetëm, në kafaz apo vërdall në shtëpi, gjatë natës me litarin të vendosur. Rreziku që litari të ngecë ose të mbështillet rreth trupit është real.

Pas shëtitjes

Nëse qeni kthehet nga shëtitja shumë i ekzaltuar dhe nga heqja e litarit nis vrapin, mbajeni litarin vënë.

Ecni qetësisht në shtëpi, ofrojini ujë, drejtojeni në krevatin e tij ose lëreni të dekompresohet pranë jush. Qëllimi nuk është ta ndaloni të shprehë gëzim, por ta ndihmoni të kalojë gradualisht nga aktiviteti në pushim.

Vrapimet e shpejta, të njohura si “zoomies”, mund të jenë pjesë normale e sjelljes së qenit. Megjithatë, nëse ndodhin vazhdimisht pas çdo aktiviteti dhe qeni e ka të vështirë të qetësohet, kjo mund të tregojë se ai ka nevojë për më shumë strukturë, pushim ose një tranzicion më të qetë pas stimulimit.

Kur qeni hipën në divan

Nëse rregulli i shtëpisë suaj është që qeni të hipë në divan vetëm me ftesë, mos i bërtisni dhe mos e tërhiqni nga qaforja.

Merrni qetësisht fundin e litarit, drejtojeni poshtë dhe më pas tregojini se ku dëshironi të qëndrojë. Zgjedhja më e mirë është ta drejtoni te krevati i tij, veçanërisht nëse i keni mësuar ushtrimin “Tek Vendi”.

Qeni nuk duhet vetëm të dëgjojë se çfarë nuk lejohet. Ai duhet të mësojë edhe alternativën e duhur.

Kur qeni duke ngrënë ose gatuar

Nëse qeni qëndron shumë afër jush, ju hidhet, kërkon ushqim ose ju pengon gjatë gatimit, mos e shtyni vazhdimisht me trup dhe mos e kapni nga qaforja.

Përdorni litarin për të krijuar distancë dhe drejtojeni drejt një hapësire të përcaktuar.

Në këtë mënyrë, ai mëson se gjatë vakteve nuk duhet të qëndrojë nën tavolinë, pranë këmbëve tuaja apo pranë sobës. Kjo është e rëndësishme si për qetësinë, ashtu edhe për sigurinë e tij.

Kur vijnë të ftuar

Mbajtja e litarit është veçanërisht e dobishme kur në shtëpi vijnë:

- fëmijë;
- të moshuar;
- persona që kanë frikë nga qentë;
- njerëz që nuk dëshirojnë kontakt të drejtpërdrejtë;
- ose vizitorë që qeni nuk i njeh.

Qeni mund t'i vëzhgojë dhe t'i nuhasë të ftuarit pa pasur nevojë të hidhet mbi ta ose t'u afrohet shumë. Qentë mund të nuhasin nga kilometra nëse bëhen kurioz për diçka. Madje vendosja e

hundës në trup nuk ka të bëjë me asgjë tjetër përveçse me zaptimin e objektit/njeriut, e cila është një sjellje të cilën nuk do donit ta përforconit nëse keni një këlysh, apo edhe një qen të rritur me tendencë për ruajtje objektiv (resource guarding).

Disa qen duan të afrohen menjëherë, ndërsa disa të tjerë kanë nevojë për më shumë distancë. Kontakti nuk duhet detyruar as nga qeni dhe as nga vizitori.

Pasi qeni të ketë marrë informacionin e nevojshëm dhe të ketë treguar një gjendje më të qetë, mund ta drejtoni në një distancë të përshtatshme ose te krevati i tij.

Për qentë që shfaqin ruajtje objektiv, frikë, reaktivitet apo histori kafshimi, prezantimet me njerëzit duhet të planifikohen me kujdes dhe, kur është e nevojshme, me ndihmën e një profesionisti.

Shmangni korrigjimet e panevojshme

Gjatë fazës së parë, litari duhet të përdoret kryesisht për drejtim dhe parandalim, jo për korrigjime.

Nëse sapo po i prezantoni qenit një rregull të ri, ai nuk mund të dijë automatikisht se çfarë prisni prej tij. Fillimisht duhet:

1. t'ia tregoni sjelljen e dëshiruar;
2. ta praktikoni në situata të lehta;
3. ta shpërbleni kur merr vendimin e duhur;
4. t'i rrisni gradualisht vështirësitë.

Nuk është e drejtë ta korrigjojmë qenin për një rregull që nuk ia kemi mësuar ende në mënyrë të qartë.

Sa kohë duhet të mbahet litari?

Litari i shtëpisë është një fazë e përkohshme, jo një zgjidhje që duhet përdorur gjatë gjithë jetës.

Për disa qen mund të mjaftojnë disa javë. Për të tjerë, procesi mund të kërkojë disa muaj.

Kohëzgjatja varet nga:

- mosha e qenit;
- historia e tij;
- sjelljet që po përpiqeni të ndryshoni;
- energjia dhe temperament;
- rutina e familjes;
- vazhdimësia me të cilën zbatohen rregullat.

Në përgjithësi, një periudhë prej afërsisht tri javësh deri në tre muaj mund të jetë e nevojshme për të krijuar zakone të reja.

Liria duhet të rritet gradualisht. Kur qeni fillon të marrë vendime të mira pa ndërhyrjen tuaj, mund ta lini litarin të zvarritet për periudha më të shkurtra dhe më pas ta hiqni në situata të kontrolluara.

Qëllimi përfundimtar nuk është që qeni të varet nga litari, por të mësojë të menaxhojë veten edhe pa të.

STRATEGJIA 2 - Ushtrimi “Tek Vendi”

Pas vitit 2020, mënyra se si shumë familje jetonin dhe punonin ndryshoi ndjeshëm.

Shumë njerëz nisën të kalonin pjesën më të madhe të ditës në shtëpi. Për rrjedhojë, edhe qentë u mësuan me praninë pothuajse të vazhdueshme të njerëzve të tyre.

Për disa familje, kjo afërsi e madhe krijoi pa dashje një rutinë në të cilën qeni:

- ndiqte pronarin nga një dhomë në tjetrën;
- nuk pushonte dot pa qenë pranë tij;
- shqetësohej kur mbyllej një derë;
- reagonte ndaj çdo zhurme;
- ruante hapësira, njerëz apo objekte;
- ose e kishte shumë të vështirë të qëndronte vetëm.

Të kalosh kohë me qenin është një pjesë e rëndësishme e marrëdhënies. Megjithatë, afërsia nuk duhet të nënkuptojë varësi.

Një qen duhet të mësojë se mund të ndihet i sigurt edhe kur nuk është fizikisht i ngjitur pas nesh.

Pavarësia fillon kur jemi në shtëpi

Shumë pronarë përpiqen ta mësojnë qenin të qëndrojë pa njerëz vetëm në momentin kur duhet të largohen.

Por pavarësia duhet të ndërtohet shumë më herët, ndërkohë që ne jemi ende në shtëpi.

Shenjat që një qen mund të ketë vështirësi me ndarjen përfshijnë:

- ju ndjek sa herë që lëvizni;
- nuk arrin të pushojë nëse nuk jeni pranë;
- qan ose gërvisht derën kur hyni në banjë;
- reagon ndaj shenjave që tregojnë se po përgatiteni të largoheni;
- leh, ulërin, shkatërron ose shfaq panik kur mbetet vetëm.

Jo çdo qen që na ndjek ka ankth ndarjeje. Gjithashtu, lodhja fizike nuk e zgjidh domosdoshmërisht ankthin. Nëse qeni shfaq panik, përpiqet të dalë me forcë, dëmton veten, nuk ha kur është vetëm ose nuk qetësohet për periudha të gjata, rekomandohet një vlerësim individual nga një profesionist i sjelljes.

Çfarë është ushtrimi “Tek Vendi”?

“Tek Vendi” i mëson qenit të qëndrojë në një hapësirë të përcaktuar, zakonisht në një krevat të ngritur, derisa të marrë sinjalin për t’u larguar.

Ky ushtrim nuk ka për qëllim vetëm që qeni të jetë fizikisht mbi një krevat. Qëllimi është që ai të mësojë të ulë ritmin, të pushojë dhe të qëndrojë i qetë edhe kur rreth tij po ndodhin gjëra të ndryshme.

Ushtrimi mund të ndihmojë në menaxhimin e situatave si:

- lehja te dera ose dritarja;
- Hedhja mbi të ftuarit;
- kërkimi i ushqimit nga tavolina;
- qëndrimi nën këmbë gjatë gatimit;
- vrapimi drejt derës;
- shqetësimi i vazhdueshëm;
- Ngacmimi i objekteve;
- vështirësia për t’u qetësuar;
- disa aksidente urinimi të lidhura me mungesën e mbikëqyrjes.

Ai nuk zëvendëson trajtimin e shkakut të një problemi serioz sjelljeje, por krijon strukturë dhe ju jep një mënyrë të qartë për ta drejtuar qenin.

Ushtrimi praktikohet nën vëzhgim

Kur praktikoni këtë ushtrim qeni nuk duhet të lihet “Tek Vendi” ndërsa ju largoheni nga dhoma ose dilni nga shtëpia.

Ju duhet të jeni të pranishëm për:

- ta ndihmuar të kuptojë kufirin e krevatit;
- ta kthyer qetësisht nëse zbret;
- ta shpërblyer për vendime të mira;
- të siguarur që nuk po shfaq stres të tepruar.

Vetëm pasi qeni e kupton ushtrimin dhe arrin të pushojë, mund të filloni të rrisni gradualisht distancën dhe kohëzgjatjen.

Si duhet të jetë hapësira?

Krevati duhet:

- të jetë i dallueshëm qartë nga dyshemeja;
- të ketë sipërfaqe të qëndrueshme;
- të jetë mjaftueshëm i madh që qeni të shtrihet;
- të vendoset fillimisht në një zonë të qetë ku nuk ka lëvizje;
- të mos jetë pranë një dërrë ose dritareje që nxit reagime të vazhdueshme.

Një krevat i ngritur e bën kufirin më të kuptueshëm, por mund të përdoret edhe një tapet ose shtrat i përcaktuar, nëse qeni e kupton qartë hapësirën.

Rregullat e ushtrimit “Tek Vendi”

1. Qeni largohet vetëm me sinjalin e lirimit

Pasi qeni është drejtuar “Tek Vendi”, ai qëndron aty derisa ta ftoni të largohet.

Mund të përdorni një fjalë si:

- “Hajde”;
- “Dil”;
- “Në rregull”;
- ose një sinjal tjetër të zgjedhur nga ju.

Përdorni gjithmonë të njëjtën fjalë, në mënyrë që qeni ta kuptojë qartë.

2. Lirojeni kur është i qetë

Nëse është e mundur, ftojini qenin të largohet kur:

- ka trup më të relaksuar (vendos të shtrihet);
- nuk po përpiqet të largohet me nxitim;
- dhe ju kushton vëmendje (sheh në sy) pa qenë tepër i tensionuar.

Kontakti me sy mund të jetë i dobishëm, por nuk duhet kërkuar në mënyrë të ngurtë nga çdo qen. Disa qen të pasigurt mund ta përjetojnë kontaktin e drejtpërdrejtë si presion. Më e rëndësishme është që qeni të jetë i qetë dhe i gatshëm të bashkëpunojë, jo ta thërrisni për tju parë në sy.

3. Afrohuni para se ta lironi

Në fazat e para, mos e thërrisni qenin nga ana tjetër e dhomës. Afrohuni pranë krevatit dhe më pas jepni sinjalin e lirimit pasi të keni prekur litarin me dorë.

Nëse e thërrisni vazhdimisht nga larg, qeni mund të qëndrojë në pritje, duke ju vëzhguar dhe duke menduar se në çdo moment do të largohet. Kur ju afroheni përpara lirimit, ai mëson se nuk ka nevojë të qëndrojë vazhdimisht në alarm.

4. Mos jepni shumë komanda njëra pas tjetrës

Nuk është e nevojshme t'i thoni vazhdimisht:

- “Ulu”;
- “Shtrihu”;
- “Rri”;
- “Mos lëviz”;
- “Qetë”.

Sa më shumë fjalë përdorni, aq më shumë qeni mund të qëndrojë në pritje të komandës së radhës.

Qëllimi është që ai të mësojë të gjejë vetë një pozicion të rehatshëm dhe të pushojë, jo të performojë një seri komandash.

Shpërblimi që qeni do të marrë nga ky ushtrim do të jete dalja prej krevatit dhe qetësia që kjo eksperiencë ofron. Nëse përdorni ushqim, lodra apo edhe fjalë përkëdhelëse/shpërblyese mund të jeni duke komplotuar kundër qetësisë që po mundoheni të ndërtoni. Ushqimi krijon ekzaltim, dhe ekzaltimi sjell lëvizje. Pra nëse ne fusim shpërblimin gjatë praktikimit të ushtrimit “Tek Vendi” mund të jemi duke ftuar qenin të dali prej aty.

Duke praktikuar dhe perfeksionuar këtë ushtrim, mund të nisni prezantimin e shpërblyesave aty, pasi atëherë do jeni duke përforcuar një sjellje që qeni juaj tashmë e quan të mësuar.

5. Nëse zbret, drejtojeni përsëri pa konflikt

Nëse qeni zbret pa sinjalin e daljes:

1. mos i bërtisni;
2. mos e ndiqni me nxitim;
3. përdorni litarin për ta drejtuar përsëri;
4. vendoseni në krevat;
5. ulni vështirësinë e ushtrimit.

Nëse qeni zbret vazhdimisht, mund të jetë sepse:

- seanca është shumë e gjatë;
- ambienti ka shumë shpërqendrime;

- qeni nuk e ka kuptuar ende ushtrimin;
- nuk ka kryer nevojat personale;
- ka nevojë për aktivitet fizik;
- Vendi është i parehatshëm ose qeni ka arsye për të qenë i stresuar.

Mos e trajtoni çdo dalje nga krevati si mosbindje, por si një mundësi për të mësuar.

Rriteni vështirësinë gradualisht

Filloni me seanca të shkurtra, në një ambient të qetë.

Më pas mund të shtoni gradualisht:

- lëvizjen tuaj nëpër dhomë;
- hapjen e një dore;
- përgatitjen e ushqimit;
- uljen në divan apo në tavolinë për të ngrënë;
- zhurma të lehta;
- një person të njohur në dhomë;
- dhe, më vonë, të ftuar ose situata më dinamike.

Ndryshoni vetëm një element në të njëjtën kohë. Mos shtoni njëkohësisht më shumë distancë, kohë dhe shpërqendrim.

Qeni nuk është një kompjuter që përditësohet brenda disa minutash. Të mësuarit kërkon përsëritje, qartësi dhe kohë.

Detyra jonë është ta sfidojmë gradualisht, pa e vendosur në një situatë që nuk është ende në gjendje ta përballojë.

Praktika e vazhdueshme e ndihmon qenin të kuptojë se qetësia nuk varet nga fakti që çdo gjë rreth tij është e heshtur. Me kalimin e kohës, ai mëson të pushojë edhe kur jeta normale vazhdon në shtëpi.

STRATEGJIA 3 - Përdorimi i kafazit të trajnimit

Kur u prezantojmë kafazin e trajnimit pronarëve që nuk e kanë përdorur më parë, reagimi i parë shpesh është hezitimi.

Disa njerëz e shohin kafazin si një hapësirë që i heq qenit lirinë ose e izolon. Ky shqetësim është i kuptueshëm, sidomos kur kafazi përdoret për periudha të gjata, si ndëshkim ose pa i mësuar qenit gradualisht se çfarë përfaqëson.

Por, kur prezantohet siç duhet dhe përdoret me masë, kafazi mund të jetë një mjet i vlefshëm sigurie, pushimi dhe menaxhimi.

Pse na nevojitet menaxhimi?

Një këlysh që sapo ka ardhur në shtëpi nuk i njeh automatikisht rregullat tona.

Ai nuk e di:

- cilat objekte mund të përtypen;
- ku duhet të kryejë nevojat;
- cilat zona janë të sigurta;
- si të qëndrojë vetëm;
- si të kalojë nga aktiviteti në pushim;
- apo si të silllet kur nuk po e vëzhgojmë.

Edhe një qen i rritur mund të ketë nevojë për të njëjtin proces, sidomos nëse:

- sapo është adoptuar;
- ka ndryshuar shtëpi;
- nuk ka jetuar më parë brenda;
- ka histori shkatërrimi;
- nuk është mësuar të pushojë;
- ose nuk e ka njohur më parë kafazin.

Kafazi nuk i mëson vetë të gjitha këto aftësi. Ai krijon një ambient të kontrolluar ku mund të parandalojmë gabimet dhe të ndërtojmë gradualisht zakone më të mira.

Çfarë duhet të përfaqësojë kafazi?

Kafazi duhet të jetë:

- një hapësirë e sigurt;
- një zonë pushimi;
- një vend ku ndodhin përvoja pozitive;
- dhe një mjet i përkohshëm menaxhimi.



Ai nuk duhet të përdoret:

- si ndëshkim;
- për ta mbyllur qenin sa herë na bezdis;
- për periudha që tejkalojnë nevojat fizike dhe emocionale të qenit;
- si zëvendësim për shëtitjet dhe ndërveprimin;
- ose për të detyruar një qen në panik të “mësohet” me vetminë.

Jo çdo qen ka të njëjtën marrëdhënie me hapësirat e mbyllura. Shumë qen mësojnë ta duan kafazin, ndërsa disa të tjerë mund të kenë histori ose ndjeshmëri që e bëjnë procesin më të vështirë.

Përfitimet e kafazit të trajnimit

Kur përdoret në mënyrë të përshtatshme, kafazi mund të ndihmojë në:

- parandalimin e përtypjes dhe shkatërrimit të objekteve;
- mbajtjen e qenit të sigurt kur nuk mund ta vëzhgojmë;
- krijimin e një rutine pushimi;
- mësimin e kryerjes së nevojave jashtë shtëpisë;
- parandalimin e vrapimit drejt derës ose dritares;
- menaxhimin e ambientit gjatë vizitave;
- përgatitjen për udhëtime;

- përgatitjen për qëndrime te veterineri;
- rikuperimin pas disa ndërhyrjeve mjekësore;
- krijimin e një hapësire ku qeni mund të tërhiqet dhe të pushojë.

Kafazi mund të jetë pjesë e një plani për të ndihmuar një qen që ka vështirësi me vetminë, por nuk është në vetvete trajtim për ankthin e ndarjes. Mbyllja e një qeni në panik mund ta përkeqësojë gjendjen dhe mund të çojë në dëmtime fizike.

Shpërbleni qetësinë

Qentë kanë tendencë të përsërisin sjelljet që sjellin një rezultat të dobishëm për ta.

Për shembull, nëse:

Qeni leh në kafaz; -> ne shkojmë menjëherë; -> hapim derën; -> e nxjerrim;

qeni mund të mësojë se lehja është mënyra më e shpejtë për të hapur derën.

Për këtë arsye, kur bëhet fjalë për një protestë të lehtë dhe jo për frikë ose panik, prisni një moment të shkurtër qetësie përpara se të afroheni dhe ta hapni derën.

Megjithatë, jo çdo lehje duhet injoruar.

Duhet të dalloni ndërmjet:

- një qeni që po kërkon vëmendje;
- një këlyshi që ka nevojë të urinojë;
- një qeni që është i parehatshëm;
- dhe një qeni që po përjeton frikë ose panik.

Shenjat e shqetësimit serioz mund të përfshijnë:

- përpjekje të forta për të dalë;
- kafshim të hekurave;
- gërvishtje të pandërprera;
- pështymë të tepërt;
- frymëmarrje të rënduar pa arsye;
- ulërima të vazhdueshme;
- mospranim të ushqimit;

- urinim ose defekim nga paniku;
- dëmtime të hundës, dhëmbëve ose putrave.

Në këto raste, mos e lini qenin të vazhdojë derisa “të dorëzohet”. Ndaloni, rishikoni procesin dhe kërkonte ndihmë profesionale nga një trajner. Duke vazhduar të praktikoni gabim mund të krijoni trauma afatgjata.

Gjendja e qetë para daljes

Para se të hapni derën, kërkonte një moment në të cilin qeni:

- nuk po shtyn derën;
- nuk po hidhet;
- nuk po leh;
- dhe ka një trup relativisht të qetë. Personalisht presim që qeni të ulet e të na shohi në sy.

Në fillim mund të mjaftojnë vetëm dy ose tri sekonda qetësi.

Me praktikë, mund të kërkonte që qeni të presë pak më gjatë dhe t’ju kushtojë vëmendje para se ta ftoni të dalë.

Nuk është e nevojshme ta detyroni të ulet ose të shtrihet duke e manipuluar fizikisht apo përsëritur komandat. Qëllimi është që qeni të mësojë se dera hapet kur ai tregon vetëkontroll, jo kur përdor forcë ndaj ekzaltimit.

Disa qen shtrihen kur janë të relaksuar, por pozicioni i trupit nuk duhet interpretuar i vetëm. Edhe një qen i stresuar mund të qëndrojë i ulur ose i shtrirë. Vlerësoni të gjithë gjuhën e trupit: frymëmarrjen, tensionin muskular, shprehjen e fytyrës dhe gatishmërinë për të ngrënë ose pushuar.

Mos i shpejtoni hapat

Nëse qeni e ka të vështirë, kjo nuk do të thotë se është kokëfortë ose se kafazi nuk do të funksionojë kurrë.

Mund të nënkuptojë se:

- hapat po ecin shumë shpejt;
- seanca është shumë e gjatë;
- dera është mbyllur para se qeni të ishte gati;
- kafazi ndodhet në një zonë shumë të zhurmshme;
- qeni ka nevojë të kryejë nevojat;
- ose ka krijuar më parë një lidhje negative me kafazin.

Qentë vërejnë tensionin tonë. Përpiquni të veproni qetësisht dhe në mënyrë të parashikueshme.

Nëse ju bëheni të paduruar, ngrini zërin ose e shtyni qenin me forcë brenda, kafazi mund të humbasë shpejt kuptimin e tij si hapësirë e sigurt. Kjo do tju çojë hapa mbrapa jo vetëm në mësimin e kafazit, por të gjithë marrëdhënies suaj me qenin.

Kur duhet të filloni?

Nëse kjo është dita e parë që po ia prezantoni kafazin, filloni gjatë ditës, jo në mbrëmje.

Kjo ju lejon të bëni disa seanca të shkurtra dhe pozitive përpara mbrëmjes. Mos prisni që qeni të hyjë për herë të parë në kafaz gjatë natës dhe të qëndrojë menjëherë aty për shumë orë.

Në fillim:

1. lëreni derën të hapur;
2. hidhni disa shpërblime brenda;
3. Drejtojeni me litar qenin të hyjë dhe të dalë;
4. jepini ushqimin në hyrje ose brenda;
5. mbylleni derën vetëm për pak sekonda;
6. hapeni përpara se qeni të shqetësohet;
7. zgjateni kohën gradualisht.

Qëllimi i seancave të para është krijimi i sigurisë, jo testimi i durimit të qenit.

Aktiviteti para kafazit

Përpara një periudhe pushimi në kafaz, sigurohuni që qeni:

- të ketë kryer nevojat;
- të ketë pasur mundësi të lëvizë;
- të ketë marrë pak stimulim mendor;
- dhe të mos jetë tepër i uritur, i etur ose i mbingarkuar.

Qëllimi nuk është ta lodhni deri në rraskapitje, por t'i plotësoni nevojat përpara pushimit.

Ushqimi në kafaz

Vaktet sugjerohet gjithmonë t'i jepen qenit brenda kafazit për të ndërtuar një lidhje pozitive.

Mos e shtyni brenda dhe mos e mbyllni derën papritur ndërsa është duke ngrënë. Për disa qen, kjo mund të krijojë pasiguri dhe ta bëjë të hezitohet të hyjë herën tjetër.

Në familjet me më shumë se një qen, kafazi mund t'i ofrojë qenit një hapësirë të qetë për të ngrënë pa u shqetësuar nga të tjerët.

Uji në kafaz

Qeni duhet të ketë mundësi të vazhdueshme për të pirë ujë dhe nuk duhet të mbahet i etur për të shmangur urinimin.

Për periudha shumë të shkurtra pushimi, menjëherë pasi qeni ka pirë dhe ka kryer nevojat, mund të mos jetë e nevojshme të vendoset tas me ujë brenda. Sidomos tek këlyshët që kanë tendencë të urinojnë më shpejtë pasi pijnë uj, por edhe dalin më shpesh.

Për periudha më të gjata, në temperatura të larta, gjatë sëmundjes ose kur qeni ka nevojë të pijë më shpesh, duhet të sigurohet ujë në një enë që fiksohet mirë dhe nuk derdhet lehtë.

Këlyshët kanë nevojë për dalje të shpeshta. Zgjidhja nuk është kufizimi i tepërt i ujit, por krijimi i një orari realist për urinimin.

Nëse veterineri ka dhënë udhëzime specifike për marrjen e ujit, ndiqni gjithmonë këshillën mjekësore.

Madhësia e kafazit

Kafazi duhet të jetë mjaftueshëm i madh që qeni:

- të qëndrojë në këmbë pa prekur tavanin;
- të ulet normalisht;
- të rrotullohet lirshëm;
- të shtrihet në një pozicion të rahatshëm.

Për trajnimin e nevojave, një kafaz tepër i madh mund t'i lejojë këlyshit të përdorë njërën anë si tualet dhe anën tjetër për të fjetur. Në këtë rast mund të përdoret një ndarëse që zhvendoset ndërsa këlyshi rritet ose të përdorni një kafaz të vogël të cilin do ta ndërroni kur qeni të rritet.

Kafazi nuk duhet të jetë aq i vogël sa qeni të detyrohet të qëndrojë i mbledhur ose në pozicion të parehatshëm.

Sinjalet verbale

Përdorni një fjalë të vetme për hyrjen, për shembull:

- “Futu”;
- “Kafaz”;
- “Shko brenda”.

Përdorni një fjalë tjetër për daljen, për shembull:

- “Hajde”;
- “Dil”;
- “Në rregull”.

Thoni fjalën vetëm një herë dhe më pas ndihmoheni qenin ta kryejë veprimi ndoshta duke i vendosur litarin që brenda kafazit.

Përsëritja e vazhdueshme e fjalëve — “Futu, Futu, hajde brenda” — e bën sinjalin më pak të qartë dhe mund të rrisë tensionin.

Për sa kohë mund të qëndrojë qeni në kafaz?

Koha e përshtatshme varet nga:

- moshë;
- kontrolli i urinimit;
- përvoja me kafazin;
- shëndeti;
- aktiviteti përpara pushimit;
- temperatura;
- dhe gjendja emocionale.

Këlyshët kanë nevojë për dalje të shpeshta për nevojat, lëvizje, socializim, lojë, ushqim dhe kontakt me familjen. Edhe qentë e rritur kanë nevojë për ndërprerje të rregullta dhe nuk duhet të kalojnë vazhdimisht periudha të gjata të mbyllur.

Udhëzimet sipas moshës duhet të shihen si orientuese dhe jo si objektiva që çdo qen duhet t'i arrijë patjetër.






Nëse keni një qen të rritur që po e mëson kafazin për herë të parë, mos filloni me disa orë vetëm sepse ai është fizikisht në gjendje ta mbajë urinën.

Filloni me kohë shumë të shkurtra, siç do të vepronit me një këlysh:

1. disa sekonda me derën të mbyllur;
2. më pas disa minuta;
3. largime shumë të shkurtra nga pamja;
4. dhe rritje graduale, vetëm kur qeni mbetet i qetë.

Mund ta zgjasni kohën me pesë deri në pesëmbëdhjetë minuta, në varësi të reagimit të qenit. Mos e rrisni kohëzgjatjen nëse ai po shfaq stres.

Më poshtë do të gjeni një orientim të thjeshtë për organizimin e pushimit në kafaz për këlyshët e moshave dy, katër dhe gjashtë muajsh.

 Mosha e këlyshit	Gjatë ditës, mes aktiviteteve	Maksimumi i këshillueshëm gjatë ditës pa pushim	Gjatë natës, mes daljeve për nevojat	 Gjumi total ditor
 2 muajsh	45–90 minuta; shpesh mund të flejë deri në 2 orë	Rreth 2 orë	2–3 orë në fillim; disa këlyshë arrijnë 3–4 orë	18–20 orë
 4 muajsh	1.5–2.5 orë	Rreth 3–4 orë	4–5 orë; disa mund të flenë 6–7 orë	16–18 orë
 6 muajsh	2–3 orë	Rreth 4 orë	Zakonisht 6–8 orë	14–16 orë



TRI MJETE, NJË QËLLIM

Litari, ushtrimi “Tek Vendi” dhe kafazi nuk duhet të shihen si tri mënyra për ta kontrolluar qenin.

Ato janë tri mënyra për t’i mësuar:

- ku duhet të qëndrojë;
- si të kalojë nga aktiviteti në pushim;
- si të përballojë distancën nga ne;
- si të marrë vendime më të qeta;
- dhe si të fitojë gradualisht më shumë liri.

Një qen nuk bëhet më i qetë vetëm sepse i themi vazhdimisht “qetësohu”. Ai bëhet më i qetë kur i krijojmë kushtet për ta praktikuar qetësinë.

Jini të qartë, të duruar dhe të qëndrueshëm.

Menaxhoni situatat përpara se të dalin jashtë kontrollit. Tregojini qenit çfarë dëshironi të bëjë dhe mos u përqendroni vetëm te ndalimi i sjelljeve që nuk ju pëlqejnë.

Liria nuk duhet t’i jepet qenit menjëherë dhe më pas t’i hiqet përmes konfliktit. Ajo duhet të ndërtohet gradualisht, ndërsa qeni tregon se është në gjendje ta përdorë me përgjegjësi.

Sa më qartë ta drejtojmë, aq më pak do të kemi nevojë ta kontrollojmë.



Dog Coaching Center

Tiranë, Shqipëri

www.dogcoachingcenter.com

Trajnerët:

Kornelia KOKONA

Arbër TËRVOLI